

VENDIM

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë i përbërë nga :

Xhezair Zaganjori	Kryesues
Admir Thanza	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar

në dhomë këshillimi, më datë 13.12.2017, mori në shqyrtim çështjen që u përket palëve:

Paditës: **Olimbi Arapi**

I paditur: **Agjensia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave Ndërtimeve Informale**

Objekti: *Deklarimin e pavlefshëm të Vendimit nr. 267, datë 02.05.2012 për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës.
Detyrimin e palës së paditur të më paguajë pagën e 12 (dymbëdhjetë) muajve si dëmshpërblim për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të njëanshme e pa shkaqe të justifikuara.
Detyrimin e palës së paditur të më paguajë pagën e 2 (dy) muajve si dëmshpërblim për mosrespektim të afatit të njoftimit.
Detyrimin e palës së paditur*

Baza ligjore: Neni 143, 144, 145, 146, 153, 154 dhe 155 të Kodit të Punës; Neni 36 i Kodit të Procedurës Civile.

Me Vendimin nr. 1864, datë 25.02.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur: “- *Pranimin e pjesshëm të padisë. – Detyrimin e të paditurit Agjensia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Ndërtimeve Informale të dëmshpërblejë palën paditëse Olimbi Arapi në masën e 10 (dhjetë) muajve pagë për zgjidhje të menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës. – Detyrimin e palës së paditur Agjensia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Ndërtimeve Informale të dëmshpërblejë palën paditëse Olimbi Arapi në masën e 2 (dy) muajve pagë për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit. - Detyrimin e të paditurit Agjensia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Ndërtimeve Informale të dëmshpërblejë palën paditëse Olimbi Arapi në masën 1.5 muajve pagë si shpërblim për vjetërsi. – Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër.”.*

Me Vendimin nr. 1609, datë 22.04.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë është vendosur: “- *Të shpallë moskompetencën e Gjykatës së Apelit Tiranë për gjykimin e çështjes civile nr. 1120, datë 23.05.2013 dhe dërgimin e akteve gjykatës kompetente, Gjykatës Administrative të Apelit.”.*

Me Vendimin nr. 380, datë 27.02.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit është vendosur: “- *Mospranimin e ankimit të palës së paditur Agjensia e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit kundër Vendimit nr. 1864, datë 25.02.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.*”.

Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs pala e paditur, Agjensia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale, me datë 02.04.2015. Rezulton se vendimi i gjykatës së apelit është njoftuar tek pala e paditur me datë 09.03.2015.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë mbështetur në nenin 63 të Ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”,

V E N D O S I :

Prishjen e Vendimit nr. 380, datë 27.02.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

Tiranë, më 13.12.2017

**Nr. 31003-01404-00-2015 i Regjistrimit Themeltar
Nr. 00-2017- 2616 i Vendimit (891)**